



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

KRYETARI

Nr. 641 Prot.

Patos, më 13 / 02 / 2026

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 11, datë 13 . 02 . 2026

PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B NR. 77, DATË 27.11.2025 "PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE NË BASHKINË PATOS DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të shkronjës "ç" të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 5 dhe neni 9 i ligjit nr. 35/2023 "Për kompetencat për përcaktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve institucioneve të administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", V.K.M-së nr. 328, datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar me V.K.M-në nr. 503, 01.08.2024 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", V.K.B nr. 77, datë 27.11.2025 "Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin 2026",

KËRKOJMË:

1. Të miratojë ndryshimin e nivelit të pagës të Sekretarit të Përgjithshëm, kategoria I-5, në pagën e pozicionit 165 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.
2. Efekti financiar do të fillojë prej datës 1 Shkurt 2026 dhe do të përballohet nga plani i Buxhetit 2026 për "Shpenzime personeli".
3. Pas miratimit të këtij projekt vendimi ngarkohen për zbatim Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Shërbimeve Mbështetëse.

GRUPI I MENAXHIMIT STRATEGJIK

Sokol Meta

Mimoza Shtëmbari

Boreta Murati

Ina Sauli

Juela Shpata

Çajup Refitaj

Mitjon Nikolla

Alket Halimi

Eneo Xhaferi

Arben Shpërdheja

Jurist: Joana Sherifi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, LEGJISLACIONIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Nr. 641/1 Prot.

Patos, më 13/02/2026

RELACION

**MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR NJË NDRYSHIM NË V.K.B NR. 77, DATË
27.11.2025 PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE NË BASHKINË PATOS
DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI PËR VITIN 2026”.**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Bazuar në V.K.M-në nr. 503, 01.08.2024 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkesës së shtuar të punës në funksion të rritjes së performancës institucionale, nivelin e përgjegjësisë administrative dhe ligjore të pozicionit, propozojmë:

Ndryshimin e pagës së Sekretarit të Përgjithshëm, kategoria I-5 në shtesën e pozicionit 165 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Për sa më sipër ftojmë Këshillin e Bashkisë Patos që të miratojë këtë ndryshim të nivelit të pagës së Sekretarit të Përgjithshëm të propozuar nga ekzekutivi.

DREJTOR

Irisi Xhelaj



ZËVENDESKRYETAR

Ina Sauli